



Republika e Kosovës
Република Косово-Republic of Kosovo
Qeveria – Влада-Government
Zyra e Kryeministrit/Канцеларија Премудера/Office of the Prime Minister

Zyra për Çështje të Komuniteteve/Канцеларија за питања заједница/Office for Community Affairs

KONKURS

Për ndarjen e granteve nga fondi për Mbështetjen e mediave të komuniteteve jo-shumicë, mediave multietnike dhe shoqatave të cilat merren me produksionin e mediave

Ndarja e granteve nga fondi për mbështetjen e mediave të komuniteteve jo-shumicë, mediave multietnike dhe shoqatave të cilat merren me produksionin e mediave, synon të mbështesë qëndrueshmërinë, profesionalizmin dhe pavarësinë editoriale të mediave të shkruara dhe elektronike në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë të Kosovës.

Grantet e ndara nga ky fond, kanë për qëllim që të mbështesin zhvillimin e kapaciteteve të mediave, promovimin e gazetarisë profesionale, aftësimin e biznesit të qëndrueshëm medial dhe mbështetjen institucionale.

Grantet do të stimulojnë zhvillimin kualitativ të shërbimeve që këto media ofrojnë për komunitetet lokale në Kosovë, ndërsa pjesëtarëve të këtyre komuniteteve ua mundësojnë realizimin e të drejtës së informimit në gjuhët e tyre.

Kriteret e përgjithshme për ndarjen e granteve

Përmes procedurave të hapura konkurruese dhe përmes një vlerësimi profesional dhe të paanshëm Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, do të përzgjedhë një numër të caktuar të Mediave të komuniteteve jo-shumicë, mediave multietnike dhe shoqatave të cilat merren me produksionin e mediave.

- Bartësit (pronarët) e frekuencave, botuesit apo producentët e pavarur që aplikojnë për grante, duhet të jenë qytetarë të Kosovës dhe veprimtaria e tyre duhet të jetë në përputhje me ligjet e Kosovës dhe në shërbim të qytetarëve të Kosovës;
- Të demonstroj nivel të mjaftueshëm të aftësive profesionale dhe organizative për të menaxhuar një medium;
- Të arsyetojnë se marrja e fondeve është e domosdoshme për mbështetjen e nivelit të shërbimeve të ofruara dhe se njëkohësisht do të zhvillojë qëndrueshmërinë financiare të

mediumit si dhe të prezantojë gjendjen e tyre financiare dhe funksionimin e tyre paraprak;

- Producentët e pavarur duhet të dëshmojnë marrëveshjen me ndonjë medium elektronik apo të shkruar për të transmetuar apo publikuar prodhimet finale të projekteve të tyre;
- Projektet e propozuara duhet të përmbajnë programe informative, edukative, debatusese, argëtuese dhe dokumentarë që janë në dobi të komunitetit. Fondi do të inkurajojë projektet e përbashkëta të mediave elektronike dhe të shkruara në gjuhë të ndryshme të qytetarëve të Kosovës;
- Dinamika dhe mënyra e pagesës së grantit si dhe raportimi i shpenzimit të grantit do të rregullohet me marrëveshjen e veçantë për shfrytëzimin e grantit në mes të ZÇK/ZKM dhe mediumit përfitues;

Limitet e fondit (grantit)

- Aplikuesit duhet të demonstroj që minimum 15% të projektit do të financohet nga burimet vetanake. Në llogaritjen e pjesëmarrjes në financim mundë të përfshihen edhe kontributet jo financiare në projekt siç është: koha e punës së stafit, puna e ekipit, shfrytëzimi i mjeteve dhe aparaturës së nevojshme për realizimin e projektit;
- Transmetuesit publik janë të përjashtuar nga e drejta për të qenë përfitues të granteve nga fondi;
- Shuma totale e granteve që do të ndahen është 200.000 euro;
- Shuma më e lartë e grantve individuale që do të ndahet do të jetë 10,000 euro, derisa perioda më e gjatë e implementimit të projektit është 12 muaj;
- ZÇK ruan të drejtën që të kërkoj modifikimin e buxhetit të propozuar të projektit. Buxheti duhet të llogaritet në **euro** dhe të jetë i bazuar në aktivitetet e përshkruara në aplikacion.

Mediumi aplikues duhet të paraqesë dokumentacionin në vijim

- Formularët e aplikimit dhe prezantimit të projektit për konkurrim duhet të plotësohen në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës (në gjuhën shqipe ose serbe), në formën sa më të përmbledhur dhe me të dhënat e sakta;
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit të pronarit të mediumit (letërnjoftimi ose pasaporta valide e Republikës së Kosovës);
- Kopja e licencës për mediat elektronike dhe kopje të certifikatës së regjistrimit të biznesit ose OJQ-së (e vlershme);

Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit do të marrë në konsideratë të gjitha aplikacionet të cilat janë dorëzuar me kohë.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Formularin për aplikim mund ta shkarkoni në web faqen; www.kryeministri-ks.net ose në www.kryeministri-ks.net/zck. **Aplikacionet duhet të dorëzohen në formën e dhënë nga ZÇK/ZKM. Aplikacionet e dorëzuara në forma të tjera nuk do të merren parasysh.**

MËNYRA DHE AFATI I APLIKIMIT

Aplikacionet mund të dorëzohen me e-mail në adresën: zck-kpz-grants@rks-gov.net, me mbishkrimin: "Fondi për mbështetjen e mediave", ose fizikisht në adresën :

Zyra e Kryeministrit

Zyra për Çështje të Komuniteteve

Ndërtesa e Qeverisë, Kati VI, Zyra nr. 606

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Aplikacionet mund të dorëzohen **çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në 16:00, nga data 25 prill deri më 14 maj 2014.**

Përzgjedhja e aplikacioneve do të bëhet brenda katër javësh nga data e mbylljes së afatit për aplikim. Një komision i pavarur i përbërë nga stafi i ZÇK/ZKM dhe ekspertëve të pavarur do të shqyrtojë të gjitha kërkesat e paraqitura dhe të njoftojë të gjithë aplikantët për rezultatet përfundimtare.